



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-003

Prishtinë, më 16 dhjetor 2014, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 DHJETOR 2014

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljeviq, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryetari, në vazhdim procedoi me këtë:

Rend dite

1. Propozimi për formimin e komisioneve parlamentare, numri dhe struktura e tyre

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare se propozimi i Kryesisë së Kuvendit për formimin e 14 komisioneve parlamentare, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 15 dhjetor 2014, nuk i mori votat e nevojshme nga deputetët.

Ai theksoi se për formimin e komisioneve parlamentare të Legjislaturës V duhet të vendosim në Kryesinë e Kuvendit se cilin propozim t'ia procedojmë Kuvendit për miratim.

Lidhur me propozimin për formimin e komisioneve parlamentare të Legjislaturës V, përkatësisht për emërtimin, numrin dhe strukturën diskutuan: Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Sabri Hamiti dhe Jasmina Zhivkoviq. Diskutimet e plota të tyre janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartpërmendur, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendit t'ia procedojë dy propozime për formimin e komisioneve parlamentare dhe atë:

- Propozimi për formimin e 14 komisioneve parlamentare - numri dhe struktura e tyre, sipas propozimit të Kryesisë së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2014 dhe

- Propozimi për formimin e 13 komisioneve parlamentare, sipas vendimit të Kuvendit, të datës 10 mars 2011.

Në fund të mbledhjes, kryetari tha se data e mbajtjes së mbledhjes plenare do të caktohet pasi të certifikohen deputetët e Kuvendit, sipas vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës, të cilët do t'i zëvendësojnë vendet e deputetëve që janë zgjedhur anëtarë të Kabinetit qeveritar.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 14:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale